



Dalës-Izlazës

Nr. 1-90
Br.

Data 21.07.2020
Datum

OBILIĆ-OBILIĆ



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opština Obilić - Municipality Assembly Obilic

Në mbështetje të nenit 43 dhe 47 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenit 47, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 48.3 të Statutit të Komunës si dhe nenit 21 të Rregullores së punës së Kuvendit thërras:

Mbledhjen e Kuvendit të Komunës (Legjislatura e VI³⁸, mbledhja e 8) me dt.30.07.2020 (e enjte) në ora 10:00, në sallën e Kuvendit komunal me këtë:


R E N D D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Raportit financiar Janar – Qershor 2020 - DEFZH
4. Shqyrtimi i kërkesës së DEFZH-së për lirimin nga taksa komunale për bizneset që nuk kanë punuar gjatë pandemisë Covid-19
5. Shqyrtimi dhe dhënia në diskutim publik e Draft Rregullores për Shërbimet e Varrimit, Rregullimin dhe Mirëmbajtjen e Varrezave
6. Shqyrtimi dhe dhënia në diskutim publik e Draft Rregullores për Ndarjen e Bursave, Kompensimin e Shpenzimeve të Udhëtimit dhe Aktiviteteve Jashtëshkollore
7. Shqyrtim i Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës për këmbim të pronës së paluajtshme në mes të Komunës, parcela Nr.P-72614055-1735, ZK Obiliq (Bedri Rexhep Lohaj dhe Blerim Bahtijar Lohaj)
8. Shqyrtimi i kërkesave
9. Të ndryshme



Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Burim Gërguri
Burim Gërguri



Dalës-Izlazno

Nr. 1-91
Br.

Data 21.07.2020
Datum

OBILIQ-OBILIC



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilic

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Kuvendit komunal, të mbajtur me dt.30.06.2020, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin këta anëtarë: Burim Gërguri (AAK), Labinot Mirena (AAK), Florije Jashari (AAK), Muhamet Mustafa (AAK) Qendresa Dubova (AAK), Enver Gashi (AAK), Shaip Paloja (LDK), Fatmir Bekteshi (LDK), Fatos Kurshumlja, (LDK), Linda Sadiku (LDK), Arbnore Nasufi (LDK), Hysni Mjeku (PDK), Lulzim Sadiku (PDK), Samire Berisha (PDK), Aziz Bici (LVV), Xhezide Dragusha, (LVV), Nora Preniqi (LB), Armend Rushiti (LB), Nazmi Gashi (Nisma), Slavisa Spasic (SL) dhe Dragan Dancetovic (SL).

Të pranishmit tjerë: Xhafer Gashi, Kryetar i Komunës, drejtorët komunal, Rexhep Zeka, UD i DKA-së, përf. i IZHL-së

Mbledhjen e udhëhoqi Burim Gërguri, kryesues i Kuvendit komunal i cili pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

R E N D D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara
3. Shqyrtimi i kërkesës së Kryetarit të Komunës për ndërrimin e kulturës në parcelën Nr.P-72614055-01842-8
4. Shqyrtimi i kërkesës së DKRS-së, për fillimin e procedurës për aktin e themelimit të Bibliotekës komunale (Biblioteka e Qytetit)
5. Shqyrtimi dhe dhënia në diskutim publik e Draft Rregullores për Ndarjen e Titujve të Nderit, Çmimeve, Mirënjohjeve dhe Falenderimeve në Komunën e Obiliqit
6. Shqyrtimi i kërkesës së Komandantit të Policisë në Obiliq
7. Shqyrtimi i KAB-it, për periudhën 2021-2023
8. Shqyrtimi i kërkesës së DAP-së, për lirimin e ngastrës Nr.01842-1, Z.K.Obiliq
9. Shqyrtimi i kërkesave
10. Të ndryshme

Kryesuesi – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës.

Aprovohet njëzërit rendi i ditës i cekur më lartë.

Pika e 1 e rendit të ditës

Të gjithë anëtarët e Kuvendit komunal ishin të pranishëm.

Pika e 2 e rendit të ditës

Aziz Bici – Propozoj që të ndahet mbledhja sepse nuk kërkohet aprovimi i 2 mbledhjeve.

Kryesuesi – Ju njoftoj se në pikën e dytë të rendit të ditës në ekstraktin e procesverbalit të dt.29.05.2020, është bërë një gabim teknik sepse është shkruar emri Qendresa Krasniqi, dhe në vend të mbiemrit Krasniqi duhet të shkruhet mbiemri Dubova.

Miratohet ekstrakti i procesverbalit i dt.10.06.2020 me 20 vota për dhe 1 votë abstenim, ndërsa ekstrakti i procesverbalit i dt.29.05.2020, miratohet unanimisht me vërejtjen e cekur më lartë.

Pika e 3 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti kërkesën e Kryetarit të Komunës, për ndërrimin e kulturës në parcelën Nr.P-72614055-01842-8.

Kryetari – Ju njoftoj se bëhet fjalë për parcelën e cila është futë në proces të shpronësimit në vitin 2013, me hekurudhën dhe tani, ju e dini se në vitin e kaluar ne e kemi kryer si proces. Këtu, bëhet fjalë për pjesën ku është një objekt, realisht një kompani e cila merret me material ndërtimor. Tani, ajo është parcelë komunale dhe ne kemi menduar që zhvendosja e tregut të ndodhë atje, edhe sipas planit zhvillimor.

Fatos Kushumlja – Mua, skica nuk më ka ardhë dhe kërkesë ka pasë, por skicë jo. Para se ti ndërrohet destinacioni, ne kishim një kërkesë më heret të atij pronarit që të paktën me ia vazhdue deri në fund të vitit sepse sipas kërkesës ai nuk mundet me zhvillue procesin brenda një periudhe të shkurtë prej 1 muaji. Në kërkesë ai thonte se i ka të punësuar 7 punëtorë, prandaj a ka mundësi që me ia vazhdue deri në fund të vitit.

Kryesuesi – Ne po flasim për ndërrimin e parcelës dhe vendosjen e tregut, por e shqyrtojmë kur vijmë te kërkesa në fjalë.

Lulzim Sadiku – Unë e mora sqarimin nga Kryetari se për cilën parcelë bëhet fjalë dhe besoj se edhe Kryetari dhe anëtarët e Kuvendit, janë ata që gjatë këtij mandati kanë punuar shumë që me pasë biznese dhe me dhënë tokë për biznese, që me punësue njerëz. Unë këtu, e kam edhe një problem tjetër se Komuna e Obiliqit, është duke punuar pa plan urbanistik, do të thotë se Kryetari po e bën punën më të madhe që po mundohet në forma të ndryshme, por planin urbanistik nuk e kemi. Unë jam për atë që kjo parcelë të mos ndryshohet derisa, ka kontratë deri në fund të vitit 2020 dhe njëkohësisht besoj se Kryetari do ta gjejë një formë që ai biznes të gjejë mundësinë të vazhdon dikund tjetër. Unë e kam ngritë shumë zërin te çështja e dhënies së tokave për operatorët ekonomik sepse kanë punësim. Kërkoj nga Kryetari që kjo parcelë nuk është me nguti derisa ka kontratë të mbetet kështu, për shkak të biznesit që e ka dhe punës që marrin pagë 7 anëtarë të familjeve të ndryshme. Besoj se bashkarisht Kuvendi dhe Kryetari, do ta gjejim një modul që me vazhdue dhe mos të mbeten 7 familjarët pa punë.

Aziz Bici – Edhe unë jam për, që z. Abdurrahman Thaqit mos t'i kërkohet lirimi i ngastrës së paku deri në përfundimin e marrëveshjes me dt.31.12.2020. Shpresoj se deri atëherë do të vie për miratim edhe plani rregullativ ku ju Ekzekutivi, do të mundë të merrnivendime të bazuar në plan, pa kërkuar votën tonë, për ndryshe kjo kërkesë e Kryetarit për ndërtimin e tregut në vendin ku po diskutojmë ishte dashur të jepet në diskutim publik.

Kryesuesi – Në këtë muaj e kemi parapa planin zhvillimor komunal dhe janë kryer të gjitha procedurat me anëtarë të Kuvendit, që kanë marrë pjesë nëpër fshatra e lagje dhe nga Ministria e mjedisit, duhet ti marrim komentet. Mirëpo, besoj se në mbledhjen e radhës si plan zhvillimor do ta kemi.

Labinot Mirena – Është e vërtetë, se në atë pjesë ka një biznes dhe që e zhvillon aktivitetin e tij, ne jemi nga Obiliqi dhe këtë e dimë të gjithë. Ne të gjithë e dimë se sa shumë fëmijë luajnë në atë pjesë dhe ai vendos material aty, armaturë deri te banesat e Hades, në mes të rrugës që është pronë publike. Ne të gjithë jemi të pajtimit dhe kolegu Lulzim, e din se kush ka aplikue atje, Komisioni dhe anëtarët e Kuvendit kanë mund me i pa dhe të gjithë janë të involvuar. Z.Lulzim, për kërkesat e Obiliqit ka qenë kundër dhe tani, po më pëlqen që qenka i interesuar këtij biznesi me i ndihmue sepse ne jemi me iu ndihmue krejtë bizneseve, nga se biznesi është biznes për të gjithë ne. Kërkoj që ti ndërrohet destinacioni sepse e shëmton pjesën në qendër të Obiliqit.

Lulzim Sadiku - Unë kam qenë kundër dhënies së atyre pronave, sepse nuk kanë mund me më bind ata, se kanë pasë biznes serioz qysh është fjala, për parcelën për të cilën po flasim. Unë kërkova prej Kryetarit që

me bë një zgjidhje dhe propozimi im ishte që të shtyhet kjo, ose do të votoj kundër sepse ne kemi biseduar në seancën e fundit me Kryetarin, për pika të shpejta qysh kemi veprue edhe pa plan urbanistik. Është fat i madh nëse, Komuna e Obiliqit ka inspektorë, ndihmës të inspektorëve, sektorë që me ia tërheqë vërejtjen nëse, nuk e ka në rregullë në vendin ku paguan qira. Unë kërkova të ruhet ai biznes, të ruhen ata të punësuar dhe kërkova në mënyrën shumë miqësore prej Kryetarit, që me gjetë një zgjidhje bashkarisht dhe prapë besoj që Kryetari ka me gjetë një modul, që ata njerëz mos të mbeten papunë. Unë propozova të shtyhet për shkak të situatës, derisa të na vjen plani urbanistik. Unë kam menduar se ky plan kalon në këtë mbledhje dhe Kryetari na ka premtue se brenda javës, do të na thirrë për shkak të rrethanave me bisedue për çështje të planit. Vërtetë, për pronat që kam votue kundër s'kanë mund me më arsyetue edhe sot, që jemi në një kohë shumë të gjatë se asnjë punëtorë për të cilët është thënë, ende nuk kanë filluar punën aty.

Kryetari – Sqaron se prona që është shpronësue, në kohën kur është bërë elaborati është planifikuar që të jetë rrugë, por meqë ne rrugën e kemi atëherë nuk kemi nevojë me bë edhe një rrugë shtesë. Ne kemi menduar me planifikim të ri, me plan zhvillimor që tregu të jetë aty sepse kanë qenë 2 opsione, njëri të jetë matanë hekurudhës, ku ka qenë ish ambullanta, që tani edhe ajo është parcelë e jona që ia kemi marrë KEK-ut. Mirëpo, ju e dini që kemi marrë vendim me rrënuë tregun dhe me zhvendosë nga aty, që mendoj sipas debateve që janë duke u zhvilluar në vazhdimësi nga DPUKP-ja, bashkë me grupet punuese kanë planifikuar që të jetë aty. Ne kemi diskutuar edhe për çështjen e bizneseve dhe secili që vlerëson se Komuna, mund të ia ofron një parcelë, ju jeni ata që jepni parcela, ndërsa ne jemi ata që e mbikqyrim se a po e realizon projektin. Ne po bëjmë përpjekje maksimale edhe zonën industriale me funksionalizue, me të vetmin qëllim që të krijojmë mundësi punësimi. Mirëpo, bëhuni të sigurtë një kompani ndërtimore me material ndërtimor në mes të qendrës, nuk do ta shihni askund. Sipas planit zhvillimor aktual nuk ka pasë planifikime të atij niveli dhe fatmirësisht në Komunë, ka filluar gjithçka të ndryshon. Ne kemi bashkëbisedue edhe me njerëz që kanë qasje në treg, se cila është mundësia më e mirë për ata dhe i kemi ofruar 2 opsione, që i kemi parcelat e lira. Në këtë rast te ish Shtëpia e Shëndetit është një hapësirë dhe mirë që ka ndodhë shpronësimi i fundit me hekurudhën sepse në atë parcelë do të bëhet zhvendosja e tregut. Ne kemi diskutue me të gjithë ata që merren me biznese të vogla se në banesat e Hades, në lokalet që janë poshtë ti zhvendosim aty, tregun e gjelbërt dhe prodhimet e qumështit të barten poshtë, ku është parcelë e jona. Ne kemi kontratë me kompaninë në fjalë, ata kanë pasë kontratë me udhën dhe ne mund ti lejmë afat atij sa të doni, por tash po flasim për një temë tjetër. Tani, kur jemi te kompania nëse, ai vlerëson se ne kemi ndonjë parcelë te zona industriale, që atij i përgjegjet dhe i plotëson kushtet sipas ligjit, atëherë pse mos me ia dhënë. Duke marrë parasysh edhe ato që tha z.Labinot, se ai e ka vendosë materialin në atë pjesë te banesat sepse dikur edhe ajo pjesë ka qenë pjesë e hekurudhës.

Muhamet Mustafa – Unë e kam parë në gjeoportali këtë parcelë, ku do të vendoset tregu dhe gjerësia e saj është vetëm 13 m. Pastaj, është edhe një parcelë afër saj që nuk e di se a është pronë komunale, apo pronë private me të njejtin numër vetëm në fund, është 18426 dhe me këtë bëhen 20 m. Unë kisha dashur të di se edhe kjo parcelë a është pronë e Komunës, që edhe në këtë të bëhet tregu, apo është pronë private që duhet me u shpronësue. Sa i përket asaj që tha z.Labinot, është e vërtetë sepse unë kaloj për çdo ditë aty dhe ka pengesa në komunikacion, që nganjëherë bëhet kolonë e gjatë e automjeteve, i zgjatin armaturat dhe atë material, që është pengesë për me u aprovue kjo kërkesë.

Kryetari – Sqaron se parcela tjetër, nuk është e jona sipas gjendjes kadastrale, por hapësira që është prej 12, ose 13 m, ne e kemi planifikue që objekti të jetë në formë të drejtë 4 m, pastaj e kanë 1 m e gjysmë, ose 2 m mundësinë e tezgave. Mendoj se do të jetë një rrugë e cila do të përdoret për shfrytëzim, për furnizim dhe një parking i cili s'do ta ngarkoj më komunikacionin. Të gjithë ata që kanë nevojë për treg, kanë mundësi me hy me u furnizu dhe me vazhdue. Ndërsa, si objekt ndërtimor dhe material ndërtimor jeni ju ata që vendosni dhe për bizneset jemi të gatshëm çdo mundësi, që mundemi me krijuë edhe do ta bëjmë. Nëse, dojmë me heq tregun që kemi nxjerrë vendim dhe vendosjen e tregut të ri, mendoj se këto duhet të bëhen të dyjat.

Aziz Bici - Por për vendin ku po flasim në hyrje të këtij objekti ishte tubuar uji i shiut ku ishte krijuar aq shumë një pus dhe ishte pengesë jo vetem për automjetet, por sidomos për këmbësorët, nëse jeni të

interesuar me pa këtë çka po e them e kam të regjistruar. Përndryshe nëse z. Abdurrahman Thaqi është biznesmen i suksesshëm siç shkruhet në kërkesën e tij, atëherë propozoj që ti lejoni një hapësirë dikund tjetër, që ai të zhvillojë biznesin e tij dhe mos t'i leni të gjithë ata punëtorë pa të ardhura.

Kryetari – Me siguri të ka dalë nga kujtesa sepse nuk është gabim, por ne e kemi miratue dhe zhvendosjen e objektit x, që ka qenë aty, nëse më kujtohet në të njejtën kohë ka qenë edhe tregu në vitin e kaluar.

Lulzim Sadiku – Unë besoj Kryetar, i përmenda ato që janë suksese dhe thashë se po punohet për të mirë, por në fakt sikur të ishte një plan rregullativ që kemi bisedue me ty, do të ishte më lehtë me punue. Unë jam pro që të punohet e kontribohet dhe është e vërtetë se kemi votue, por me siguri në atë mbledhje ka mungue anëtari z. Aziz Bici. Unë e di dhe kemi bisedue, që çdo ndërtesë që e kemi rregullue për çështje të Obiliqit, ne kemi qenë pro. Unë kërkova nga Kryetari për shkak të punëve që po bëhen, me gjetë një modul me shtye deri në vitin e ri, me i dhënë mundësi biznesit dhe nuk thashë se ai s'po pengon dhe është mirë se aty po duket bukur sepse unë kur s'duket bukur shumë herë e kam përmendë gjelbërimin. Mirëpo, unë thashë që me i dhënë kohë operatorit dhe besoj se Kryetari, do ta gjejë një modul me shtye derisa ta kemi planin rregullativ. Kolegu po thotë 13 m dhe unë e kam shikue seriozisht dhe kam mendue se është 11 m e 90 cm, hapësira për të cilën po flasim. Pra, kërkoj që ti jepet mundësia atij operatori deri në fund të vitit që me indihmue edhe atë sepse e kemi operatorë ekonomik nga Komuna e Obiliqit dhe këtu, s'po bëjë politikë sepse shumë operatorë ekonomik që i kemi ndihmue janë të huaj. Besoj se Kryetari do të bëjë gjithçka që me gjetë një modul. Unë kështu e thashë, po kërkoj në mënyrë shumë të sqartë e njerëzore, që me gjetë një modul, ne bashkarisht dhe atij operatori me ia bë një zgjidhje.

Enver Gashi – Unë nuk e di se vetë po dojmë me zvarritë, apo secili po don diçka me thënë me arsytue veten që ka ardhë këtu. Unë e kuptova se këtu, janë 2 tema, dhe nuk është mirë që po e përzieni shëndrrimin e destinacionit prej një ndërmarrje, që është ndërtimore në një treg, që Obiliqit i mungon dhe gjetjen e mundësisë për operatorin, dikund me ia dhënë një hapësirë. Dihet qysh jepet hapësira dhe ne nuk po ia shpronësojmë operatorit, por është shpronësim prej hekurudhës sepse sikur të ishte e operatorit ndoshta, do të kishim pasë të drejtë ligjore dhe morale, atij njeriu me ia gjetë zgjidhjen. Sot kërkohet të votojmë për, ose kundër vetëm ndërrimin e destinimit dhe po i përzieni temat, e po i maltretoni asambleistët dhe të tjerët që janë prezentë.

Hysni Mjeku – Tash, po diskutojmë për 3 çështje paralele, planin urbanistik rregullativ nuk e kemi, kush e pengon këtë pronë sepse nuk kemi të bëjmë me atë dhe çështja e ndërrimit të destinacionit të kësaj parcele. Ne e kemi shqyrtue kërkesën e përmendur, që unë edhe si biznes dhe personalitet e çmoj jashtëzakonisht dhe kam kërkuar edhe në Komitet që mundësisht me ia shtye afatin sepse është material ndërtimor, që nuk shitet kur ai don. Sa i përket çështjes së planit rregullativ është çështje tjetër, që prapë ne kemi me diskutue. Pra, edhe te tregu ne nuk e kemi planin urbanistik dhe rregullativ sepse është një projekt minor që mundemi me zhvendosë kudo, që është e mundshme. Apeloj që nëse, Kryetari ka mundësi që këtij biznesi ti mundësohet së paku edhe 4,5 muaj sepse tash është sezona e verës dhe ai ka mundësi me shitë materialin ndërtimor. Unë kam kërkuar edhe në Komitet se këtë biznes vërtetë, nuk bën me anashkalue. Tash, ne nuk duhet ti ngatërrojmë shumë çështjet edhe urbanistike dhe procedurale sepse prona faktikisht tash është komunale, që është e qartë se askush s'ka të drejtë me ndërhye.

Kryetari – E zbërthjem çështjen dhe ne jemi duke diskutue për 2 tema, që nuk nënkupton se ne s'kemi me bë ndërrimin e kulturës, që nesër kemi me ia nisë. Pra, do të kërkohet edhe një hapësirë dhe një gjë ta keni parasysh se tregu është projekt që e kemi bërë me rishikim të buxhetit dhe është projekt që është grand. Sa i përket çështjes me ndihmue biznesin, ju jeni ata që vendosni për pronat komunale. E kemi zonën industriale, zonën biznesore atje, nëse ai e shehë veten atje, apo nëse e shehë dikund tjetër, ju keni me shqyrtue prapë. Nëse, ne e nisim këtë procedurë sot minimumi 1 muaj ditë në kushte normale shkon për ndërrimin e parcelës, por fatmirësisht që është pronë komunale, ndërsa pjesën tjetër mundemi me pa deri në fillim të realizimit. Nëse, ju thoni deri në shtator, ne mundemi me ia shtye deri në shtator, por duhet ta keni parasysh se Komuna i humbë afërsisht 50,000-60,000 €.

Lulzim Sadiku – Unë po flas edhe si grup dhe si personalitet dhe neve, na preokupon sepse plani urbanistik

nuk lidhet për qielli, por lidhet për prona komunale. Ne kemi diskutue me Kryetarin edhe për fshatra, që unë e përmenda para 1 muaji, që na ka premtue se do të ju thirri gjatë javës me bashkëpunue për planin urbanistik, që është dokumenti kryesor i Komunës. Unë mendova që e lëvdova Kryetarin, që po ka suksese edhe për pikat që po flasim edhe për sheshin dhe për çështjen që po flasim. Ne jemi duke folë për çështje komunale, për plan urbanistik të Komunës, që lidhet me atë pjesë dhe për atë operatorë ekonomik. Edhe unë nuk jam për me humbë tregu i Komunës së Obiliqit, por thashë se duhet me gjetë një modul.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 13 vota për, 5 vota kundër dhe me 3 vota abstenim e miratuan Vendimin për Ndërrimin e kulturës të shfrytëzimit të parcelës Nr.P- 72614055-01842-8, në sipërfaqe prej 6143 m² dhe shfrytëzimit aktual të parcelës nga Infrastruktura – Rrugë e Rendit I në tokë ndërtimore, pronë komunale.

Pika e 4 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqet kërkesën e DKRS-së, për fillimin e procedurës për aktin e themelimit të bibliotekës komunale (Biblioteka e Qytetit).

Lulzim Sadiku – Ne si grup jemi pro kësaj kërkesë sepse vërtetë është kërkesë e kahmotshme.

Anëtarët e Kuvendit komunal unanimitisht e miratuan Vendimin për Themelimin e Bibliotekës komunale – (Biblioteka e Qytetit).

Pika e 5 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqet kërkesën nga Drejtoria e administratës së përgjithshme për shqyrtimin dhe dhënien në diskutim publik të Draft Rregullores për Ndarjen e Titujve të Nderit, Çmimeve, Mirënjohjeve dhe Falenderimeve në Komunën e Obiliqit.

Lulzim Sadiku – Unë i përgëzoj ata që kanë punuar në këtë Rregullore, edhe pse do të delë në dëgjim pastaj, do të vjen në Kuvend, ku do ti japim disa vërejtje që i kemi. Unë kisha kërkuar që këtu të parashihen edhe flamurat sepse Kryetari e ka theksuar në mbledhjen e fundit, që kur të mbahen festat në fakt me qenë e rregulluar edhe çështja e flamurit, përndryshe ne jemi pro kësaj kërkesë, por ajo të jetë si pikë që për çdo ndarje të bëhet ndryshimi i flamurit dhe vërtetë Kryetari e ka kuptue.

Fatos Kurshumlja – Edhe ne e përkrahim këtë kërkesë.

Aziz Bici – Edhe ne jemi pro kësaj kërkesë.

Nazmi Gashi – Mendoj se është dashur me qenë një Rregullore dhe shumë mirë që po bëhet sepse e kemi një rend për ndarjen e mirënjohjeve dhe shpërblimeve se kush e meriton dhe kush nuk e meriton. Shpresoj se ne jemi një Komunë, që njihemi të gjithë dhe në bazë të Rregullores, në bazë të rendit njerëzit që kanë dhënë kontribut, që e meritojnë dhe kanë respekt do të marrin shpërblime. Drejtësia nuk mbahet me Rregullore, por mbahet te ne, te shpirti ynë se a jemi egoistë dhe a po e pranojmë realitetin, do të thotë se ai që e meriton vërtetë të shpërblehet. Unë shumë herë e kam parë se drejtësia te ne mungon dhe kjo shihet haptas sepse edhe ata që e kanë meritue, nuk po mund të vijnë në rend me marrë atë që kanë kontribue 40, 50 vjet, për diçka që me ia mundësue edhe atyre.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal unanimitisht e miratuan Vendimin për dhënien në debat publik të Draft Rregullores për Ndarjen e Titujve të Nderit, Çmimeve, Mirënjohjeve dhe Falenderimeve në Komunën e Obiliqit.

Pika e 6 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqet kërkesën e Komandantit të Policisë në Obiliq.

Kryetari – Ju e dini se me plan zhvillimor, ne kemi menduar me lirue edhe këtë pjesën tjetër dhe shpresojmë se kjo do ta bën një zgjidhje për stacionin policor. Është shumë e vërtetë, se ne ia kemi marrë parkingun atje, nga sheshi dhe ata kanë telashe të jashtëzakonshme. Ne duhet me bë zgjidhje të parkingjeve për shkak të rrethanave të krijuara ku është pjesa e premiumit, do ta ketë edhe një pjesë të parkingut, këtu ku është heqë restoranti i KEK-ut, do të vazhdon me 20 parkingje, përreth qysh është kjo vija që janë parkingjet atje lartë. Ne po bëjmë përpjekje që me plan zhvillimor në të ardhmen me zgjidhë problemin e parkingut edhe te pjesët tjera.

Lulzim Sadiku – Pyetja e parë është se këto 2 parcelat, që janë me nr.6970, a flitet për 2 parcela sepse aty

është Qendra e Regjistrimit Civil, pjesa e Komunës që bashkëpunojnë me neve, ajo pjesa në mes të ndërtesës dhe qendrës. Pyes a është ajo pjesa që po flasim për 2 objekte, banesat e vjetra aty që ka mbetet ndërtesa dhe kjo pjesa lartë, apo ku është çështja sepse këto 2 parcela, janë pak të përziera. Sa i përket parkingjeve, Komuna e Obiliqit është keq, që Kryetari veç e ceku dhe plani zhvillimor urbanistik duhet me i gjetë mundësitë, me i gjetë format për parkingje sepse jemi keq. Unë kisha kërkuar jo me ia dhënë stacionit të policisë si zonë, por me ia dhënë në shfrytëzim për 10 vjet dhe me mbetë pjesë e Komunës, sepse Kryetari ka premtuar se do ta gjen një modul me mund me largue edhe stacionin e policisë dhe Komunën. Mendoj se është mirë me ia dhënë për një kohë të caktuar sepse nëse, ne mendojmë që stacioni policor ta gjejë dikund një pozitë tjetër, atëherë kjo të mbetet pjesë e Zyres së shërbyesve civil. Mua, më intereson se a është ajo hapësira që është afër 10 m, në mes të objektit dhe objektit të Qendrës së Regjistrimit Civil, dhe kjo pjesa përmbi deri te Qebaptorja “Meti” për cilën pjesë jemi duke biseduar.

Kryetari – Sqaron se bëhet fjalë për rrethojën që e dini se ku e kemi te Qendra e Regjistrimit Civil, që e kemi lënë vetëm një rrugë për me hy në polici. Këtu, bëhet fjalë për një parcelë 131 m, dhe parcela tjetër është 164 m, pastaj është edhe një parcelë e jona, do të thotë janë 3 parcela në të njejtin vend, nga rrethoja e policisë është e jona. Pastaj janë 2 shirita që njëra është 131 m dhe tjetra 164 m. Parcelat nuk i jepen në shfrytëzim policisë, por kjo bëhet parcelë komunale, pastaj parkingun ne mundemi me ia lënë policisë në shfrytëzim. Tani çështja e bartjes së parcelave, edhe stacioni i policisë dikur ka qenë KEK, por tani është Komunë dhe këtë e kanë në shfrytëzim pa ndonjë afat, do të thotë sa ne e vlerësojmë që mundemi me lëshue edhe për qytetarë tjerë. Mirëpo, problemi është se ne zyrtarëve policor ua kemi marrë atë pjesën që e kanë pasë në qendër atje, dhe është në shfrytëzim, por pa ndonjë afat, as bartjen në pronësi të tyre.

Lulzim Sadiku – Kërkesa është ndryshe, dhe ju e sqaruat shumë në rregullë. Mua, më intereson te ndërtesa e Regjistrimit Civil, dhe në mes të banesave është një hapësirë dikund 10-12 m, a ka mundësi hyrjen stacioni i policisë me pasë në atë vijën, ku po flas sepse është një hapësirë aty, që nuk di se a është pronë e Komunës. Do të thotë hapësira, në mes të ndërtesës së Regjistrimit Civil, që me ua lënë parkingun më lartë, që mos me pasë policia dhe parkingun në të njejtën vijë, që mos me pengue.

Kryetari – Sqaron se atë që po e përmendë, ne e kemi si mundësi, por është mjaft ngushtë dhe s’mund të kthehen aty 2 vetura dhe në të ardhmen, ne ose duhet me revidimin e projektit të sheshit “Dëshmorët e kombit” për me mbetë objekti i bardhë sepse edhe ai është pjesë e sheshit. Në pamundësi të buxhetit, ne faktikisht këtë e kemi lënë, por pjesa e gjelbërt me plan zhvillimor qysh është planifikuar dhe me projektin e sheshit, është pjesë e gjelbërt. Duhet me pa si mundësi, por kjo pjesa që po flasim për parkingun, policia do ta ketë zyrtarin aty ku e ka në të ardhmen dhe kjo pjesë do të jetë për palë, zyrtarë policor që kryejnë shërbim gjatë orarit ashtu, qysh e kanë pasë përpara.

Fatos Kurshumlija – Kisha me thënë se si Komuna, me ia ndërtue se nuk e di qysh shkon tash përgatitja me gjetë një zgjidhje që Komuna, me ua bë edhe me postë administrative parkingun.

Kryetari – Faktikisht, ne e dijmë se një pjesë e etiketeve që i qesin policia vijnë në Komunë, mendoj se një parking që është afër 3 ari, mund të jetë edhe 4 ose 5 ari, prapë po e them se ajo ka me mbetë pjesë e jona dhe ne do ta bëjmë parking, për me lënë në shfrytëzim zyrtar. Vlerësimi bëhet si zakonisht me vendim që shkon te Ministria e Planifikimit Hapësinor, në Ministrinë e financave, pastaj Ministria e bën vlerësimin e pronës, të këtyre 2 parcelave dhe varet çmimin a e pranon pala, apo nuk e pranon. Rëndësi ka se ne e planifikojmë edhe pjesën lartë, që është objekti ngjitë me lokalin “Meti” në fazat e ardhshme duhet me shpronësue.

Aziz Bici – Edhe ne jemi pro kësaj kërkesë sepse është në pyetje parkingu, është në pyetje zgjidhje më e mirë dhe lehtësimi i punëve. Unë e kam edhe një lutje për Kryetarin, që sa herë ti përmendë institucionet e Komunës, policinë, shkollat, QKMF-në, është mirë me përmendë edhe postën sepse është institucion i shtetit dhe është mirë mos me na harrue krejtë. Pa marrë parasysh se kush punon aty, posta është dhe do të mbetet institucion i shtetit, jo pse duam ne por po jetojmë në Evropë dhe çdokund në Evropë, posta është dhe mbetet institucion i shtetit.

Kryetari – Mbi të gjitha ne planifikojmë edhe për postën me bë një zgjidhje, ose me vazhdue me ndërrim të

pronave, të hapësirave që juve ju mjaftojnë, ose me bë një renovim. Besoj se javën në vazhdim kemi me ia nisë me intensifikue këtë çështje pak më shumë, për arsye se na ka mbetë mjaft keq.

Nazmi Gashi – Për planin zhvillimor urban të Komunës, kemi biseduar edhe me Kryetarin, dhe njerëzit mendojnë se është punë e lehtë. Mirëpo, kjo është puna më e rëndë profesionale për grupin punues, bile parashihet që arkitektët dhe inxhinierët, të cilët nuk kanë përvojë nuk mund të punojnë në këtë segment. Mendoj se këtyre ditëve, mos po parashihet stacioni policor me u largue, por është mirë të mendohet të mbetet aty ku edhe është. Në planin urban parashihet zhvillimi ekonomik, zhvillimi kulturor, ndërsa në fund si kapitulum i të gjithave, është pjesa e sigurimeve të segmenteve shtetërore, që me ua mundësue dhe me i dhënë sipërfaqe, aq sa iu vyen. Mirëpo, duhet me lënë edhe rezerva sepse ndoshta, vjen dita me u zhvillue edhe pjesa e sigurisë të pikave më të larta. Shpresoj se Kryetari dhe unë do të jemi prapë anëtarë të Kuvendit dhe rezultatet nuk do të mungojnë. Ne nuk duhet të hezitojmë për me iu ndihmue njerëzve të cilët japin kontributin më të madh për sigurinë e qytetarëve. Ne e kemi nisë mirë dhe besoj se afër 4 vjet, ose 8 i kemi bashkë, kështu që mund të dalim me një rezultat shumë më të mirë.

Kryetari – Sqaron se ne kemi planifikue me vendosë ku është restoranti i KEK-ut, por ka kërkesa që mos të vendoset stacioni aty, me mbetë park dhe ndoshta, stacioni edhe ashtu kështu edhe 4,5 vite, do të mbetet aty ku është. Ne duhet ta bëjmë bashkarisht një punëtori me shikue çdo detal, çdo propozim që ka ardhë nga grupet punuese me qëllim që ta bëjmë një plan zhvillimor të përshtatshëm dhe implementues.

Aziz Bici – Fushata është edhe pak largë dhe unë të kisha thënë mos rri më anëtar i Nismës, nuk është kohë fushate, ti votën që e ke marrë e ke marrë për Nismë, e jo për Aleancën dhe unë shumë të përkrahu nëse, ti del në Aleancë, sa shumë e jepë kontributin që është krejtë në rregullë. Mirëpo, të jesh anëtar i Nismës dhe vazhdimisht në çdo seancë të japësh kontribut për Aleancën aq shumë mua, ma merrë mendja se nuk është mirë. Ne për të mirat kemi me qenë bashkë gjithmonë për derisa ekzistojmë si subjekte politike, atë ditë që unë e shohë se nuk mendoj ndryshe, nuk reflektoj ndryshe prej të tjerëve, unë ose largohem dhe japë mundësi nga këtu me u largue. Unë jam në një subjekt dhe jam anëtar që mendoj ndryshe, prej juve edhe si Vetëvendosje edhe si individ, për atë edhe e kam kërkuar votën.

Nazmi Gashi – Unë u luta, Kryetar që ti bashkë me mua me qenë edhe në një mandat anëtar i këtij Kuvendi. Tani, po të tregoj drejtë si vëlla se shumë më afër jam me kalue në Vetëvendosje se sa në Aleancë.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal unanimisht e miratuan Vendimin për shpalljen me interes të përgjithshëm publik parcelat me Nr.01869-0, dhe Nr.01870-0, në Obiliq.

Pika e 7 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqet kërkesën nga DEFZH, për shqyrtimin e KAB-it, për periudhën 2021-2023.

Kryetari – Planifikimi për vitin 2021, është plani i përgjithshëm 2 milion e 325,764 €, plani specifik i Arsimit, 2 milion e 600,591 €, grandit specifik për shëndetësi është 807,703 €, total grandit është 5 milion e 734,58 €. Të hyrat vetanake janë 1 milion e 22,665, mjetet nga Ligji i Obiliqit, janë 4 milion e 600,000 €, që në total buxheti është 11,356,723 €. Kategoritë ekonomike janë: paga dhe medijtje janë 4 milion e 203,938 €, mallra dhe shërbime janë 750,000 €, shpenzimet komunale janë 180,000 €, subvencione dhe transfere janë 250,000 €, shpenzimet kapitale janë 350,000 e 120 €, grand.

Pastaj, Kryetari i njoftoi të pranishmit në mënyrë detale për KAB-in, për periudhën 2021-2023.

Lulzim Sadiku – Te pjesa e investimeve, më është dukur shumë interesantë sepse ne kemi mundësi me sqarue deri në muajin shtator dhe aty pashë 825,000 €, për kogjenerim. Unë dua të di saktë se a kemi ndonjë bashkëfinancim, apo i kemi lënë mjetet si rezervë që në fakt me na ardhë ndonjë donatorë sepse pasi që janë të dhëna për kogjenerim ruhen dhe nuk mund të shkojnë mëtutje, apo vetëm i kemi lënë rezervë dhe po presim çka po ndodhë. Pyetja e dytë është te 50,000 €, rregullimi i parqeve që vërtetë këto parqet që po i ndërtojnë nëpër fshatra janë shumë të mira, si ti specifikojmë që një fshat me pasë një park, që Komuna e Obiliqit, me pasë mirëmbajtjen e tij. Mirëpo, jo të ndërtojmë parqe pa u bërë një analizë e mirë sepse po na mungon prona komunale, prandaj është mirë të specifikohen 50,000 €, parqe, por në cilin vend. Kryetar, unë pajtohem si fshat që Mazgiti, me pasë një park, por mos me i pasë 3 parqe sepse nuk është bërë një analizë e thukët dhe është mirë me kursye pronën komunale. Pastaj, e pashë 20,000 €, për drunjë, që unë jam

munduar me dhënë kontributin tim dhe Kryetar me drunjë jemi të dështuar, jo vetëm ti, por edhe ne që jemi në Kuvend jemi të dështuar. Unë kam thënë edhe më heret, e di që je ithtar për drunjë dhe qëllimi yt ka qenë që ata drunjë sot me qenë 20 m, por fatkeqësisht asnjë që 7 vjet nuk e ke mbi 2 m e 20 cm. Pra, kam vërejtje te këto 20,000 €, për drunjë dhe jam kundër sepse nuk po mirëmbahen dhe nuk po zhvillohen, ose janë drunjë bregdetarë dhe nuk po tregojnë sukses dhe po dështojnë. Përndryshe, unë jam pro KAB-it, sepse kjo edhe mund të ndryshohet në shtator në buxhet, por bëhet ndryshim edhe në dhjetor.

Fatos Kurshumlija – Mund të them se është dita e parë se ne prapë do të diskutojmë për buxhet deri në vitin 2021. Mua, 2 gjëra më shtyen të diskutoj te derivatet, shpenzimet komunale janë 55,000 €, që i bjen dikund rreth 230 €, derivate Komuna në ditë me i shpenzue, që mendoj se është shumë. Pastaj, te rregullimi i fushave sportive janë 210,000 €, dhe sa e di unë 80 - 90 %, fushat nëpër shkolla, nëpër fshatra janë përfunduar dhe pyes se a është në pyetje mirëmbajtja e tyre apo rregullim i ri.

Aziz Bici – Unë kam ardhë në përfundim se një pjesë e madhe e drunjëve janë duke dështuar, po flas për rr."Afrim Zhitia" në fshatin Mazgit dhe aty ku shihet se i kanë ujtitë drunjët disa familje nuk kanë dështue, por aty ku shihet se nuk janë ujtitë drunjët kanë dështue. Unë mendoj se faji kryesor është te mosujtitja, do të thotë te mospërkujdesja. Në rast se konstatohet kështu, ajo kompani që është marrë me mbjelljen dhe përkujdesjen e drunjëve, mendoj se duhet me ndërmarrë masa. Sa i përket subvencioneve, edhe në mbledhjet e kaluara kam kërkuar se ose duhet vazhdimisht me bë kërkesa me shkrim që me bë një raport të Komisionit, se çfarë efekti po kanë subvencionet qoftë të bujqësisë, apo qoftë tjera. Pyes, kur do ta kemi një informacion të saktë që të dijmë se këto subvencione, a janë duke u kërkuar mirë dhe duke u shfrytëzuar mirë. Mendoj se në rast se na e sjellni raportin për gjithë këto vendime që po i merrni, atëherë për neve do të jetë më lehtë për me votue, apo për mos me votue. Pajtohem me Kryetarin se krahasuar me vitet e kaluara është duke ndryshuar Obiliqi, por krahasuar me buxhetin që e kemi ne, Obiliqi nuk është duke ndryshuar. Një buxhet aq i madh në rast se këto projekte janë duke u ekzekutuar, mirëmbajtur në rregullë sipas ligjeve dhe kritereve, që është dashur me qenë mendoj se Obiliqi kishte me ndryshue më shpejtë.

Nora Preniqi – Edhe unë deshta të ndërlihem për drunjët që i ceku z.Lulzim, dhe unë kam parë rrugës për Mazgit, se të gjithë drunjët që janë mbjellë dikund janë rritë, e dikund nuk janë rritë. Te familja ime e kanë bërë konkretisht sistemin pikë pikë dhe aty, janë bërë drunjët e mirë. Mendoj se drunjët janë bimë dhe ne të gjithë duhet të përkujdesemi, sigurisht se vërejtja duhet të jetë edhe për kompaninë e cila i mirëmban, edhe për pastrimin e trotuareve sepse edhe aty kam parë se ka bari nëpër kocka. Prandaj, edhe ne duhet të përkujdesemi pak më shumë.

Nazmi Gashi – Mendoj se investimet që po bëhen me këtë vetëdije që e kemi, ne nuk kemi mundësi me u përmirësue dhe me nxjerrë hap pozitiv me këtë vetëdije e sjellje ndaj infrastrukturës së sotshme që po ndërtohet. A besoni, se kujt i ka shkue mendja se në Sibofc, shkon kanalizimi sepse një shtëpi është në kodër, tjetra shumë largë, që në mes veti s'mund të takohen. Aty, nuk ka shtëpi që nuk ka shkue kanalizimi, rrjeti i rrymës në tërësi, rrugët e asfaltuara në tërësi dhe ujësjellësi ka kalue. Mirëpo, shkojnë e i gjuajnë mbeturinat në kanalizim dhe nuk ka në botë që mund të mirëmbahet kjo, kështu që ne me qytetarin tonë duhet të bisedojmë, duhet të dijmë se çka bën, e çka nuk bën. Mendoj se inspektorët nga Drejtoria e inspektorëve dhe nga Mbrojtja e Mjedisit duhet të veprojnë dhe nëse ka nevojë me rritë edhe numrin e tyre, që vërtetë me qenë ashpërsia administrative, zbatimi i ligjit sepse shkeljet nuk po bëhen pa qëllim.

Qendresa Dubova – Desha të pyes te Drejtoria e shëndetësisë, te blerja dhe pjesët për dijalizë në QKMF figuron një shumë e caktuar që me siguri ka ndodhë një gabim teknik, vetëm deshta ta di shumë e mjeteve.

Lulzim Sadiku – Këtu, u përmend Sibofci, dhe vërtetë në Sibofc janë bërë punë të mira falë buxhetit, Kryetarit dhe Kuvendit, që është organi më i lartë, ka sukses dhe shumë gjëra të mira, që janë ndërtue por duhet të vazhdohet të punohet për fshatin Sibofc. Sa i përket asaj se janë të lidhura fermat nëpër kanalizime, unë nuk mendoj se janë dhe fatmirësisht në Sibofc, janë 5 ferma të mëdha që duhet me gjetë një modul që me iu dhënë subvencione. Kërkoj që sektori i bujqësisë me i vizitue për me mund me iu ndihmue atyre fermave. Është bërë një ndriçim tepër i mirë në lagjen tonë në fund të Sibofcit, është kanalizimi i cili duhet të mirëmbahet, përndryshe unë jam nga Sibofci që jetoj në Sibofc dhe fermat nuk janë të lidhura me

kanalizim. Unë nuk dua ta kundërshtoj fqinjnin tim, por kam kërkuar prej tyre me bë zgjidhje sepse i kanë bërë disa gropa skeptike, që në fakt pengojnë edhe plehrimin e arave të tyre, përmes tyre.

Nazmi Gashi – Unë nuk thashë në Sibofc dhe z.Lulzim, nuk e din se unë kam qenë 20 vite, kryeinspektor që e di se ka raste të tilla, por thashë se duhet me pasë pak kujdes.

Aziz Bici – Këtu, u përmendën vetëdija dhe inspektorët dhe unë fola rreth kompanisë dhe obligimeve të saj. Qytetarët të cilët janë duke i ujitur drunjët, po i ujitin vullnetarisht dhe nuk e kanë pasë obligim. Unë pajtohem se ata janë përgjegjës për mirëmbajtjen e tyre, por të paktën të kemi drunjë të mbjellur që janë largë familjeve, kemi edhe më afër por nuk janë rritë. Unë nuk mund të flas për kompetencën se duhet të rritet numri i inspektorëve sepse duhet me pasë argument. Mendoj se nëse, ne bashkëpunojmë me qytetarë dhe i besojmë qytetarëve e qytetari na beson neve, atëherë edhe ky numër i inspektorëve kishte me iu ardhë rreth. Mirëpo, sa janë të gatshëm me punue inspektorët kur dihet se ne kemi mjaft ankesa të tjera, janë duke e shfrytëzue rrugën publike, mezi kalon prej rrugës dhe këto nuk janë që nuk i dijmë dhe nuk është që nuk kanë kohë. Për fshatin Sibofc, kisha dashur me ma dhënë një informatë sepe e di se në lagjen Krasniqi, lartë mungon uji, e ju thatë se ka edhe ujë. Unë jam dalë përpara dhe nuk është pak se e ndiej veten fajtor që nuk jam shkue prapë me i vizitue, është viti 2017 dhe lagjia Krasniqi, te Publicët nuk ka pasë ujë, kanë pasë mungesë të ujit. Në rast se thua, që ka ujë unë të falenderoj për këtë informatë dhe normal për Kryetarin që e ka dërgue atje ujin dhe i ka furnizue me ujë.

Nazmi Gashi - Unë thashë z.Aziz, se është rrjeti i Komunës dhe ujësjellësi është i Komunës, sipas kapaciteteve dhe ne kemi menduar për kapacitetin e pompave që e dërgojnë ujin në sistem nuk i plotësojnë kushtet. Mendoj se faji nuk është te rrjeti, por është me rëndësi se rrjeti është në gjendje të përgatitur.

Kryetari – Fillimisht i përgjegjem z.Lulzim Sadiku, për kogjenerimin që janë të ndara 825,000 €, në këtë vit janë të planifikuara 300,000 €, që të fillon objekti i nxemjes qëndrore, kogjenerimi dhe 825,000 janë pjesa tjetër për me u mbyllë si projekt total kogjenerimi. Projekti si projekt e dini të gjithë se është dikund rreth 38 milion dhe ne kemi aplikue edhe me Ministrinë e integriteteve, me qëllim që të krijojmë ndonjë mundësi të përfitimit në fondet ndërkombëtare. Ne si Komunë jemi të renditur në mesin e 5 Komunave, që mundemi me përfituenë këtë rast. Çështja e drunjëve, seriozisht është shqetësuese dhe më vjen keq një pjesë të tyre njerëzit e papërgjegjshëm po i dëmtojnë dhe e dini qysh janë mbjellë, janë mbjellë në kohë dhe të përforcuar me shtylla, por në ndërkohë i kanë dëmtue. Kompania i ka në përkujdesje dhe unë mundem me ua dëshmue se ata disa herë në vitin e kaluar i kanë ujitë, por jo mjaftueshëm, ose drunjët kanë qenë të dëmtuar. Ne kemi kërkuar të gjithë drunjët që janë tharë të hiqen tash dhe jo të zëvendësohen tash sepse është sezonë, që nuk bën me i zëvendësu. Në fillim të marsit nuk kanë mund me i zëvendësue për shkak të pandemisë dhe ne kemi kërkuar prej menaxherit të projektit, që të ketë kujdes dhe të bëjë numrimin e të gjithë drunjëve. Po ashtu, të bëjnë dëshmi bashkë Komisioni ynë me Komisionin e tyre dhe përfundimisht ta përmbyllim me një marrëveshje, ashtu që edhe nëse skadon afati i kontratës, ai me u pajtue që drunjët me i mbjellë në tetor, nëntor kur është koha e mbjelljes së tyre. Te rregullimi i fushave, që e tha fatmirësisht edhe z.Aziz, dhe e dijmë të gjithë që këtë buxhet që e kemi afërsisht 11 milion e gjysmë, e dikur e kishim 4 milion e 700, do të thotë po krijohen mundësitë secilën herë me bë veprime në të mirën e qytetarëve, që kjo lidhet edhe me pyetjen e z.Fatos, për fushat sportive. Ne për çështjen e pronave i kemi 2 opzione, 1 e kemi në KBI që në kushte të marrëveshjeve që ekzistojnë përmes AKP-së, ne mund ta bëjmë vetëm 20 % e pagesës së pronës në fjalë për me u vlerësues çmimi i Ministrisë. Mundësinë tjetër e kemi se një pjesë e madhe e pronave janë të KEK-ut, në hyrje të Palajve e kemi shpallë një zonë me interes publik dhe besoj se në vitin e ardhshëm kemi me zgjidhë. Te Grajqevcët, që shkon rrugës për Palaj kemi informata se ajo pjesë është e KEK-ut, e shpronësuar dhe jemi duke bashkëbiseduar me menaxherin e ambientit, që edhe atë pjesë me trajtue me hy me memorandume të përbashkëta KEK-u tokën, ne punën dhe aty me shëndrue në një park, pjesë rekreative, fushë aporative. Pastaj, e kemi te Alijovit, ajo pjesa andej që e kemi shumë keq, e kemi pjesën e Plemetit, pjesën e Baimocit, fshatin Bakshi, por për shkak të pandemisë që ndodhi, ne është dashur me i ndalë aktivitetet. Poashtu, ka nevojë të bëhet një fushë sportive në Llazarevë, edhe Lajthishta ka nevojë nëse, krijohen mundësitë me pasë një fushë sportive dhe ende kemi mjaft tema që me mund me i

trajtime. Unë nuk di a e kemi diskutue çështjen e nënshkrimit të memorandumit me KEK-un, për një projekt për pyllëzim dhe shëndërrimin në park të një zone prej 100 ha që mendohet të zgjerohet për 10 ha, në pjesën tonë që është pronë e KEK-ut. Ne kemi bashkëbisedue me KEK-un, në këtë rast me drejtorin e ambientit dhe kemi një raport të jashtëzakonshëm në aspektin e bashkërenditjes së aktiviteteve. Në këtë rast falë KEK-ut, me AKP-në, mundësinë e pronës që ne kemi mundësi me shfrytëzue edhe pjesën e brendshme ose bankinën me bë të gjelbërt, ndërsa pjesën e jashtme e bëjmë një pistë për biçikleta, mundësinë e një staze nga Obiliqi deri në parkun Obiliq-Fushë Kosovë, që do të jetë një park i jashtëzakonshëm. Studimin e fizibilitetit e ka krye KEK-u, dhe tani jemi në fazën e projektit ideor, aplikimi në Ministri dhe faza e parë është 6-8 milion. Subvencionimi ishte pyetje e përgjithshme dhe unë e them prapë, se kjo nuk është vetëm meritë e imja, por edhe e Ekzekutivit dhe Kuvendit që ne shumë aktivitete i kemi bashkërendit. Nëse, fillojmë nga Arsimi janë dikund rreth 500 nxënës, studentë të Komunës tonë që përfitojnë bursë, ose që janë me ndihmë sociale në shkollë të mesme, që përfitojnë bursa dhe është çështja e udhëtimit prej fshatrave në gjimnaz dhe teknikë. Te shëndetësia kemi filluar tash edhe me lehonat që do të jenë përfituese dhe rastet të cilat mundohemi me i ndihmue vazhdimisht. Ne në vitin e kaluar i kemi dhënë 50,000 €, me kërkesën e grupit joformal të grave se do të ndihmohen gratë në biznes, ose ato që kanë ndonjë projekt. Sa i përket subvencionimit të bujqësisë psh të gjitha kafshët vaksinohen me subvencionim të Komunës, që është një projekt pastaj, subvencionohet qumështi 5 centë, është mbarësimi dhe kontrollat në Komunë, pa e llogaritur mbështetjen e bizneseve me sera, kultivatorë e produkte tjera. Sa i përket veturave, ishte pyetja nga z.Fatos, për derivate aktivitetet janë të jashtëzakonshme dhe e falenderoj gjithë Ekzekutivin që janë shumë të kujdesshëm. Pyetja e znj. Qendresa, për një veturë të dijalizës që ne mundemi me ble, por në javën e kaluar na e sjelli një donator që e falenderoj shumë dhe mori si obligim se do ta sjellë edhe një për dijalizë. Për ujin në Sibofc, kemi diskutuar disa herë, rrjeti ekziston dhe problemin e kemi gjatë sezonës së nxehtë sepse po bëhet ujitja e arave. Ne kemi bërë disa ankesa se jemi të interesuar nëse, është e nevojshme me participue në sistem të pompimit që të jetë më funksionale. Poashtu, ka pasë raste kur ne inspektorët tone i kemi ofrue në dispozicion nëse, është e nevojshme me dalë bashkë me ujësjellësin me ndalë atë dukuri të keqe.

Lulzim Sadiku – Te çështja e gjelbërimit, unë nuk thashë se në varrezat të Hashanët, janë mbjellë drunjë me qëllim që ti me marrë masa me i shkurtue, sepse prekun në tension të lartë dhe janë të dështuar. Përndryshe, shumë i qartë isha, që e the edhe vetë se ke pasë dëshirë që ata drunjë me qenë në gjatësi, me qenë të rregulluar sipas standardeve, por në fakt asnjë nuk është rritur në 2 m e 20. Mund ti gjejmë 10 drunjë Kryetar, por numri është shumë i vogël dhe besoj se edhe ti e din se ka dështim te drunjët që e pranove. Unë vetëm te varrezat kërkova se janë nën tension të lartë dhe këtë vit janë mbjellë në 4 m dhe ende pa e kryer ne mandatin ata prekun lartë dhe duhet me i shkurtue, që janë komplet të dështuar dhe do ti japë shifrat në mënyrë miqësore. Te parqet, ti fole për fushat për 50,000 €, dhe unë thashë se është mirë në çdo fshat me ndërtue një park, në çdo vend që me i plotësue standardet. Mirëpo, jo psh në një hapësirë shumë të vogël me i ndërtue 3 parqe, sepse po na duhet prona komunale, po duhen shumë investime edhe në mirëmbajtje. Poashtu, nuk është specifikue saktë edhe për 825,000 €, sikur të ishte sqaruar qysh e sqarove ti çështjen e kogjenerimit, unë do të isha shumë i qartë. Te parqet, është mirë me ruajtë pronën sepse na duhet për vendosjen e postës, stacionit policor e tj. Kryetar, ka shumë parqe dhe ju mund ba bëni një vizitë sepse nuk janë duke i mirëmbajtë. Këto 50,000 €, nuk i sqarove dhe ti fole për fusha sportive, e jo për parqe.

Hysni Mjeku – Meqë, jemi te buxheti e nderuara drejtoreshë e financave, na ke dhënë një udhërrëfyes 2021-2023, por kur e aprovojmë buxhetin sigurisht se do të na e sjellni buxhetin në formën analitike dhe sintetike. Shumica e anëtarëve që janë këtu, prezentë kanë kaluar nëpër këto faza dhe e dijnë mirë se çka do të thotë Korniza Afatmesme Buxhetore, që është vetëm një orientim se ku do të mbërrijmë. Ne kur e analizojmë buxhetin, do të ndalemi te investimet kapitale, që janë jetike për qytetarët. Këtu, u fol shumë dhe dikush kërkon kanalizim, dikush ndriçim edhe pse në këtë pikë të rendit të ditës, ato nuk duhet të kërkohen sepse janë dhënë shifrat në mënyrë totale, do të thotë për këtë projekt kur do të zbatohet, vjen koha kur do të diskutojmë. Meqenëse, vijë nga zona e epërme e Komunës, një pjesë e kanalizimit është e kryer, por nuk ka ndriçim publik, as nuk ujësjellës, as parqe që ju po i kërkoni. Në fshatin Grabofc i Epërm, janë 2,3 parcela të

mjaftueshme për ndriçim dhe për me qenë parqe të fshatit. Ne nuk kemi drunjë dekorativ, megjithatë drunjët që janë ne i ruajmë dhe kultivojmë sepse vijë nga ajo zonë. Nga askush prej juve këtu, nuk u diskutua për atë pjesë edhe pse ajo pjesë është shpallë zonë me interes të veçantë, e vetmja që ka mbetë me zhvillue edhe biznesin, edhe turizmin. Vetë fakti që u diskutua këtu për projektet vlen të kuptohet se shumë projekte janë kryer dhe pa vërejtje, por a është dashur me u krye edhe më mirë, sigurisht se po. Ne kemi mbjellë drunjë dekoartiv që nga koha kur ishte z.Mehmet Krasniqi, Kryetar dhe në krahasim me situatën tash janë në gjendje jashtëzakonisht të mirë, kuptohet edhe disa janë dëmtuar që kjo rrjedhë nga kultura e vetë neve qytetarëve. Ne nuk e kemi obligim me i ujit drunjët, bile ke bërë një delikt të fortë nëse, ke shkuar aty dhe i ke prekë sepse mund të ndodhë edhe me u dëmtue, me tu adresu dhe mundet me tu fajësue ty ai problem. Për mbrojtjen e monumenteve të trashëgimisë nuk u folë pak këtu, sepse ne vijmë nga një rajon që vetëm një mulli është i mbrojtur nga Ministria, ndërsa ne i kemi 4 mulli që kanë funksionue në kohën më të vështirë dhe më të mbrojtur dhe tash që janë në mëshirën e kohës. Edhe këtu, është mirë të ndahen një pjesë sepse së pari është pasuri komunale, por edhe të nivelit qëndror. Meqë, jam edhe anëtar i KPF-së, pse i kemi dhënë dritë të gjelbërt këtij buxheti, do të thotë e kemi konstatue se mjetet e ndara nëpër programe janë të mjaftueshme për këtë periudhë me mundësi të rritjes së vazhdueshme. Prandaj, unë jam pro kësaj Kornize Afatmesme Buxhetore.

Kryetari – Kërkoj falje z.Lulzim, se të kemi mbetë pak borxh për dhënien e përgjegjes te Drejtoria janë në total 150,000 €, për rregullimin e parqeve, por ne kemi planifikue edhe për vijën e bashkëfinancimit që e përmenda me KEK-un. Mirëpo kur e bëjmë Kornizën e dytë buxhetore, që e vlerësoni me rritë nuk ka problem. Rregullimi i parqeve në Komunën e Obiliqit, janë 50,000 grand, por këtu janë edhe 20,000 €, dhe 10,000 €, janë të hyra, do të thotë 80,000 €, është totali.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 13 vota për dhe 4 vota abstenim e miratuan Vendimin për (KAB) Korniza Afatmesme Buxhetore 2021 (2022-2023).

Pika e 8 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqet kërkesën e DAP-së, për lirimimin e ngastrës Nr.01842-1, Z.K.Obiliq.

Enver Gashi – Mendoj se nuk është mirë me thënë 1,2, ose 3 muaj, por është mirë me ia caktue saktë njeriut, se kur neve afërsisht na duhet, e jo kur ai e nisë projektin me i thënë dil pavarërisht kush është, nuk është në rregullë. Pra, më mirë është me thënë që nga sot për 60 ditë, e liron hapësirën dhe ne vazhdojmë me projektet tona.

Lulzim Sadiku - Unë në emër të grupit propozoj që atij me ia dhënë mundësinë deri me 31 dhjetor 2020, për shkak të biznesit dhe kontratës që e ka, sepse ai mundet me kërkue të drejtën e tij dhe me na u dëmtue buxheti komunal.

Fatos Kurshumljia – Ne e përkrahim këtë kërkesë.

Aziz Bici – Unë kërkoj të respektohen procedurat të cilat kërkohen dhe mos të dëmtohet interesi i tij, do të thotë se në rast se lejohen procedurat respektoni ato dhe vazhdoni.

Armend Rushiti – Unë e përkrahu kërkesën e këtij biznesi, që brenda mundësive me ia shtye afatin, derisa të bëhet një zgjidhje.

Nazmi Gashi – Mendoj se janë kriteret se cilat veprimtari lejohen në atë zonë dhe është mirë brenda mundësive me i ndihmue.

Kryetari – Edhe unë jam për me i ndihmue biznesit dhe besoj se secili prej juve, jeni për me i ndihmue biznesit, por nëse ne hyjmë me 50,000 €, me ndërtue tregun, ne nuk pretendojmë me ia mbyllë biznesin. Propozoj me ia dhënë 60 ditë, që besoj se për këtë kohë ai si biznes është dashur me gjetë një alternativë tjetër, sepse tek e fundit nuk është parcelë e tij, do të thotë se ai paguan qira që mund të gjejë edhe dikund tjetër. Mirëpo, nëse ai ka ndonjë kërkesë në zonën industriale, që ne mundemi me ia aprovue sipas ligjeve në fuqi dhe nëse, ju e aprovoni si Kuvend, ai mund të zhvendoset atje. Ju duhet të llogaritni se nëse e mbështesim deri në dhjetor ne mund ti humbim 2 projekte, ju e dini se ne kemi nxjerrë vendim për tregun dhe nuk mund ta zhvendosim tregun aty, si dhe nuk mundemi me planifikue pjesën tjetër “Dëshmorët e

kombit” që kemi thënë me vazhdue deri ku është tregu. Ne mund ta mbështesim, nëse ai ka nevojë për ndihmën tonë, por jo duke e dëmtue komplet procesin.

Aziz Bici – Në rast se vërtetë tregu i gjelbërt do të ndërtohet atje, do të shfrytëzohet dhe e dijmë se do të jetë në interes të qytetarëve, unë e përkrahu propozimin për 60 ditë. Në rast se vërtetë shfrytëzohet ky treg dhe muaji korrik së shpejti po fillon, për ndërtim ka kushte për me u ndërtue, por për me u shfrytëzue tregu mendoj se është mirë me analizue prej atyre që marrin vesh në tregti. Nëse, vërtetë nuk mund të shfrytëzohet si sezonë tregu, atëherë propozoj ti shtyhet afati deri me 31 dhjetor 2020.

Kryetari – Sqaron se po z.Aziz, ne planifikojmë me shfrytëzue maksimalisht, tash për dallim në tregun që e kemi ne kemi vendosë, që të vendosen pemë e perime, produkte të qumështit dhe bletaria. Grupi joformal i grave, ka pasë një kërkesë që në treg të jetë një pjesë për grupin joformal të grave për shitjen e produkteve të veta si mjaltin, qumështin, djathin, por me bë taman me standarde. Pjesa tjetër që e kemi tani në treg, që janë biznese, rrobaqepësi, sallone ondulimi e biznese tjera, do të vendosen te banesat e Hades 1 dhe Hades 2. Prandaj, mendoj se 60 ditë, me i dhënë afat atij, kompenzim s’do ti kërkojmë pastaj, pas 60 dite na liron hapësirën me mirëkuptim që ne ta zhvillojmë projektin tonë.

Lulzim Sadiku – Unë vërtetë, kërkoja që të shtyhet afati për 6 muaj, sepse është Covid 19-i, është çështja e Prokurimit, ne vërtetë e kemi edhe problemin e pazarit i cili qe 20 vjet, është ashtu qysh edhe ka mbetë. Unë nuk dua të bëjë politikë, por po kërkoj modul sepse ai është një njeri dhe menaxher i mirë, operatorë që ndihmon shumë, i cili nuk lejon me humbë një projekt prej 50,000 €. Prandaj po kërkoj vetëm për shkak të Zyres së Prokurimit, derisa të kryhen procedurat dhe nuk jam për me bë politikë, por jam për me bë një zgjidhje të mirë, me i dhënë mundësi një biznesi që është i Komunës tonë, me pasë një privilegj më të madh.

Kryetari – Sqaron se te projekti që e përmenda afati është 20 ditë, në vlera të vogla, e jo 45 ditë, që është në vlera të mëdha. Qëllimi është që ne me ia lënë atij një afat prej 2 muajve, që ai brenda 2 muajve me mundë me bë zgjidhje.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal unanimitisht e miratuan Vendimin për aprovimin e kërkesës së qytetarit Abdurrahim Thaqit, pronar i firmës N.T.P. Devolli për lirimimin e Ngastrës nr.01842/1, në sipërfaqe prej 6142 m² ZK Obiliq.

Pika e 9 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqet kërkesën nga MAPL-ja, për rishqyrtimin e vendimit nr.I-26, të dt.28.02.2020, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës së Obiliqit, në ZK Llazarevë ofertuesit “Baruti Group”. Ju njoftoj se rekomandimi i KPF-së, është të shfuqizohet vendimi i cekur më lartë.

Lulzim Sadiku – Më vjen mirë që kanë nisë këto vendime të cilat i kemi marrë dhe nuk i kemi arsyetue të kthehen në pikën 0. Unë jam pro, mos me ia vazhdue.

Kryesuesi – Sqaron se vendimi në tërësi është arsyetue, por Ministria ka kërkuë dokumente shtesë për biznes dhe ai nuk ka qenë i gatshëm ti sjellë ato dokumente.

Aziz Bici – Ne, jo vetëm për këtë vendim që pritet ta votojmë për shfuqizim, por do të jemi për shfuqizimin e të gjitha vendimeve, për të gjitha ato prona që janë dhënë për 99 vjet, në shfrytëzim dhe që ne kemi votuar kundër. Mirëpo, sigurisht se në të ardhmen do të bëjmë çmos që ti shfuqizojmë ato vendime sepse nuk janë në interes të zhvillimit ekonomik.

Kryesuesi - Z.Aziz, unë nga këndi im nuk kisha me thënë sepse është kosto që lidhet me një vendim, ka ligjshmëri, është kontrata që e ka koston e vet, por për këtë rast nuk kemi lidhë kontratë, vetëm se vendimi iu ka nënshtruar ligjshmërisë së detyrueshme. Edhe në KPF, kemi diskutue se firma “Baruti Group” nuk ka të drejtë më me aplikue në asnjë ofertë për shpallje të dhënies së pronës në shfrytëzim.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal unanimitisht e miratuan Vendimin për shfuqizimin e vendimit përfundimtar nr.I-26, të dt,28.02.2020 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës së Obiliqit, në Zonën Kadastrale në Llazarevë, ofertuesit “Baruti Group”.

Kryesuesi – Ju njoftoj se i kemi pasë edhe 2 kërkesa për shqyrtim në KPF, dhe ia kemi rekomanduar Drejtorive përkatëse. Poashtu, e kam edhe një kërkesë nga kordinatorja e KKSB-së, znj.Suzana Hashani për marrjen e vendimit për anëtar në KKSB, ashtu që në vend të Agim Spahiut vjen Rexhep Zeka.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 12 vota për, 5 vota kundër dhe 1 votë Abstenim e miratuan vendimin për emërimin z.Rexhep Zeka, anëtar në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) në vend të anëtarit Agim Spahiu.

Pika e 10 e rendit të ditës

Hysni Mjeku – Në mbledhjen e KPF-së, i kemi pasë 2 kërkesa dhe kemi pasë kërkesën e fshatit Bakshi. Këto, ishin kërkesa legjitime dhe të nevojshme. Bëhet fjalë për një rrugë dhe unë e kuptoj se çdo rrugë publike është rrugë shtetërore, por këtu, dallon pak esenca se qysh ka qenë ajo, qysh ka kalue ajo në kadastër nuk e di, por pala don me ditë se ajo rrugë është e tij dhe e ka lëshue për nevoja të veta sepse shtëpinë e ka në fund dhe ai ka mund me kalue në shtëpinë e vet pa kalue përmes asaj rruge. Ajo rrugë dikund i ka rreth 200 m, dhe ne në KPF, i kemi sugjerue Drejtorisë përkatëse, që në mbledhjen e radhës të Kuvendit, me na dhënë një sqarim.

Kryesuesi – Ju njoftoj se njëra kërkesë ka qenë nga Sejdi Hashani dhe kërkesa tjetër nga Ismet Mjeku, të cilat në KPF ia rekomanduam Drejtorive përkatëse për shqyrtim.

Lulzim Sadiku – Një vendim që e ka kthye MAPL-ja, nga mbledhja e fundit për pagat jubilarë për mësimdhënës, e ka kthye në pozitën 0, dhe ne e kemi lënë për këtë muaj.

Kryesuesi – Sqaron se ne kot mund të marrim vendim sepse ai nuk mund të realizohet.

Lulzim Sadiku - Unë e kam edhe një kërkesë për çështjen e 15 mësimdhënësve, plus 2 që kanë vdekë pa i marrë pagat, qysh i takojnë sipas rregullave 3 pagat e fundit. Ne kemi marrë një vendim dhe kemi kërkuar nga Kuvendi komunal, që ata me i tërheqë lëndët nga Gjykata dhe ata 15 mësimdhënës dhe 2 që kanë vdekë nga ata, kanë pasë paga shumë të vogla në vitin 2012, 2013 dhe nëse i paguajmë si pagesë është shumë e vogël, sa që ndikon shumë pak. Kërkoj që të shtrohet si kërkesë sepse edhe Kryetari ka qenë për me marrë një vendim pasi që i kanë tërheqë lëndët nga Gjykata me i pague jo vetëm ata 15 vetë, por edhe ata 2 që kanë vdekë, do të thotë 17 mësimdhënësve, me ua bë atë pagesë.

Kryesuesi – Ne mund ti rekomandojmë Drejtorisë së Arsimit, që brenda një muaji të gjejë një modalitet dhe në mbledhjen e radhës vendosim për këtë çështje.

Lulzim Sadiku – Unë kam biseduar me secilin veç e veç dhe ata lëndët i kanë tërheqë dhe iu kam thënë se Kryetari është për me krye këtë çështje dhe nëse, ne i rekomandojmë Drejtorisë së Arsimit, besoj se kjo punë do të përfundoj shumë shpejtë.

Aziz Bici – Ne këtu, kemi qenë prezentë, por Kryetari ka thënë le ti tërheqin lëndët dhe fillon procedura. Unë kisha me kërkue nga z.Lulzim, që të merrë këtë iniciativë, ti merrë dokumentet si dëshmi që i kanë tërheqë lëndët nga Gjykata, ti dërgohen këto Drejtorisë përkatëse dhe ti shtrohen procedurave. Arsyeja pse është e rëndësishme pika e rendit të ditës “Të ndryshme” është sepse jo të gjitha grupet jemi të përfaqësuar në Komitetin për Politikë dhe Financa, dhe nuk kemi mundësi me propozue rendin e ditës. Unë për këtë arsye i ftoj të gjithë anëtarët e Kuvendit komunal, që të kenë durim dhe të dëgjojnë. Unë e di se po na vjen material dhe duhet mjaft kohë për me lexue atë material se çka po bëhet sidomos në pikën e fundit të rendit të ditës. Unë i kam 3 çështje dhe njëra është sikur të ishte Kryetari prezentë do të ishte më mirë, por sigurisht se kryesuesi këtë e ka parasysh. Është një shqetësim i imi dhe i banorëve të fshatit Mazgit dhe me rrethinë ardhja e disa grupeve nga Serbia, çdo vit që vijnë me rastin e 28 qershorit. Ne e dijme se kjo nuk ka qenë para vitit 89, por ka fillue me ardhjen e Sllobodan Millosheviqit, person i cili përfundon deri në luftën e fundit në mes të UÇK-së dhe ushtrisë armike serbe. Kërkesa ime për Kryetarin është në rast, se nuk është i mjaftueshëm KKSB-ja, të bashkohemi me MPB-në, me të gjitha Ministrinë, të cilat munden me na sjellë një raport të një analize se kush janë këta, cili është qëllimi i ardhjes së tyre, jo qëllim politik sepse ne për qëllim politik e dijme. Ne për ardhjen e tyre deri më sot nuk kemi informacion zyrtar, por vetëm përmes mediave. Prandaj, mendoj se është detyrë e Kryetarit bashkë me KKSB-në, të na përgatitë një raport se kush po vjen që po rrezikohet rendi dhe siguria, a po shkakton përçarje, apo urrejtje, apo cili është qëllimi i tyre.

Ndërsa, kryesuesi kur të përgatitet ky raport duhet me propozue në rendin e ditës në një seancë të ardhshme që të shqyrtohet në KPF.

Kryesuesi – Raportet e KKS-së, ju e dini se vijnë në fund të vitit dhe në rastin konkret ne mundemi me rekomandue që të jepë raport MPB-ja, dhe atë raport ne mundemi me ua dërgue në email, por në rend dite nuk kemi të drejtë me i përfshi dhe raportet e policisë nuk kemi të drejtë me i diskutue.

Aziz Bici – Unë të shtunën me dt.27 qershor, kam një informatë se prej orës 17 e 48’ asnjë barnatore në Komunën e Obiliqit, nuk ka punue. Në rast se nuk punon vërtetë, asnjë barnatore dhe nuk kujdestaron, atëherë unë kërkoj nga Ekzekutivi ose nga drejtoresha e DSHMS-së, që të konsultohen me përfaqësuesin zyrtar të barnatoreve, që për çdo ditë dhe për çdo natë një barnatore të kujdestaroj, e jo qytetari të shkoj në Obiliq për një ilaç. Kjo informatë le të vendoset në QKMF, në një vend të dukshëm që qytetarët të jenë të informuar se cila barnatore është kujdestare atë ditë. Në seancën e kaluar unë e kam ngritë çështjen e largimit të banorëve të objekteve të rrënuara, ka qenë fjala për Ismet Bërbatovcin dhe Kryetari tha se ai ka banim, por Kryetari është bind se nuk është fjala për Ismet Bërbatovcin, që ai ka aludue, por është fjala për një Ismet Bërbatovc, tjetër.

Kryesuesi – Për pyetjen e parë do ta keni njoftimin, te pyetja e dytë e di se është një marrëveshje qysh kujdestarojnë dhe oraret janë publike.

Flori Jashari – Orari shihet se është në derë të ambulancës për çdo kujdestari se cila barnatore funksionon.

Aziz Bici – Pyet se a ka barnatore në Obiliq, që funksionon 24 orë.

Flori Jashari – Përgjegjet se deri në ora 11.

Hysni Mjeku – Meqenëse ne kemi marrë vendim për pagesën e arsimtarëve, kërkoj që Drejtoria përkatëse, deri në seancën e ardhshme të Kuvendit, ti ekzekuton këto vendime sepse ne kemi marrë vendim edhe Kryetari ka qenë pro kësaj kërkesë. Sa i përket çështjes së kujdestarisë, plotësisht pajtoj me parafolësin duhet me kujdestaru 24 orë, sepse deri në ora 11 është shumë normale me punue. Orari duhet të vendoset në barnatore, e jo në ambulancë sepse nuk kam nevojë të shkoj në ambulancë, por shkoj ku është barnatorja. Për çështjen e ardhjes së grupeve që tha z.Aziz Bici, e kryesuesi tha se nuk është i obliguar me na raportue, jo është i obliguar me na raportue, për çka e kemi thirrë ne atë organ. Komandanti i policisë është i obliguar me i raportue Kryetarit të Komunës, ndërsa Kryetari neve na njofton.

Nazmi Gashi – Kryesues, ne me kushte jemi prapa, dhe sipas planit të punës së Kuvendit, ne duhet të dalim një ditë e ta bëjmë një vizitë dikund. Po ashtu, kam një pyetje si qëndron çështja e pagesave për neve.

Fatos Kurshumlija – Ne kemi diskutuar më heret për gurëthyesin në Sibofc, sidomos në atë mbledhje Nënkryetari ka marrë mjaft përgjegjësi për gurëthyesin në Sibofc. Unë një ditë kalova andej dhe ata e kishin përgatitë vendin për me fillue punue aty. Unë nuk di kryesues, a ke kalue ti andej me pa apo jo.

Kryesuesi – Sqaron se nuk ka kurgjë në atë drejtim.

Nora Preniqi – Unë e kam një brengë të qytetarëve të Mazgitit, te pishat nuk lejohet frekventimi i banorëve të lagjeve tjera.

Kryesuesi – Për shkak të pandemisë me vendim të Qeverisë kanë qenë të ndaluara parqet, por për më shumë sqarim është DSHPE-ja dhe DI-ja, që duhet me ndërmarrë masa në këtë drejtim.

Lulzim Sadiku – Në fshatin Sibofc, te përoni thuhet se na mbytën mushkonjat dhe pyetja nga një qytetarë është se a ka Komuna, dezinfektues që vijnë për spërkatjen e tyre sepse thuhet se nuk po jetohet në shtëpi. Ne e kemi ndarë një buxhet për Bashkësinë fetare, për një kapellë për kufoma në pritje, dhe pyes se çka ka ndodhë.

Kryesuesi – Sqaron se e kemi planifikue, por nuk kemi ndarë mjete.

Hysni Mjeku – Meqenëse, vijë nga pjesa e fshatit Grabofc i Epërm, kemi një shqetësim të qytetarëve se në kohën e fundit, janë shpeshuar shumë vjedhjet e bagëtive. Prandaj, e lus Kryetarin e Komunës dhe kryesuesin që të bashkëpunojnë sa më ngushtë me komandantin e policisë dhe policia të vëhet në kërkim sepse vërtetë, gjendja është alarmante.

Mbledhja përfundoi në ora 13:20'

Bashk.prof.për punë të KK


Azize Zeneli



Kryesuesi i Kuvendit komunal


Burim Gërguri